



**VENDIM**

**Nr. 92, Datë 09.06.2016**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PER MIRATIMIN E RREGULLORES  
PER ZGJIDHJEN E MOSMARRREVESHJEVE DHE TRAJTIMIN E  
ANKESAVE MES KLIENTËVE DHE TË LICENSUARVE NE  
SEKTORIN E ENERGJISE ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “ë”; 24, pika 1 dhe 2 te Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë elektrike”; nenit 17, pika “ë”; neni 98, pika 1 dhe 2 te Ligjit Nr. 102/2015 “Për Gazin Natyror”; dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 09.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të ERE, në lidhje me miratimin e “Rregullores për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave mes klientëve dhe te licencuarve ne sektorin e energjisë elektrike dhe te gazit natyror”

**Konstatoi:**

- ERE është organi kompetent për hartimin dhe miratimin e kësaj rregulloreje.
- Njehsimi i praktikës së rregullave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror, krijon lehtësira për të gjithë operatorët e tregut.
- Rregullorja për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave mes klientëve dhe te licencuarve ne sektorin e energjisë elektrike dhe te gazit natyror përcakton kushtet dhe procedurat për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin mes te licencuarve dhe klientëve ne sektorin e Energjisë Elektrike dhe atë të Gazit Natyror.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për miratimin e “Rregullores për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave mes klientëve dhe te licencuarve ne sektorin e energjisë elektrike dhe te gazit natyror.”

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë te interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**